



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 18 mars 2024  
Nr. ref.: RK2409/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI127/23**

Parashtrues

**Tahir dhe Đurđica Ramqaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë  
së Aktgjykimit AC-I-22-0008 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të  
Gjykatës Suprem etë 3 shkurtit 2023**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SE KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Tahir dhe Đurđica Ramqaj me vendbanim në Zagreb, Republika e Kroacisë, të cilët përfaqësohen para Gjykatës nga Isak Hoxha (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [AC-I-22-008] të 3 shkurtit 2023, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C-III-15-0001] të 22 nëntorit 2021 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar).
3. Parashtruesit e kërkesës, Aktgjykimin e kontestuar e kanë pranuar më 8 shkurt 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij themelore të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenein 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ-së).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 9 qershor 2023, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 15 qershor 2023, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI127/23], caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues, ndërsa përmes Vendimit [Nr.KSH.KI127/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci, (anëtarë).
9. Më 20 korrik 2023, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrim të kërkesës dhe kërkoi nga ai që përputhje me nenin 21 të Ligjit dhe rregullin 32 (2) të Rregullores së Punës të dorëzon në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
10. Më 3 gusht 2023, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë, autorizimin e kërkuar.

11. Më 26 tetor 2023, Gjykata njoftoi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për regjistrim të kërkesës dhe dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesit e kërkesës kishin pranuar vendimin e kontestuar.
12. Më 1 nëntor 2023, Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i'a dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregon se parashtruesit e kërkesës aktin e kontestuar e kishtin pranuar më 8 shkurt 2023.
13. Më 13 shkurt 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës ishin drejtuar pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme:AKP), me kërkesë për blerjen e banesës me sipërfaqe 68 m2, në Banjë të Pejës, me pretendimin se e njëjta i'u ka ndarë nga atyre nga Enti i Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitimit në Banjë të Pejës.
15. Më 23 korrik 2014, Bordi i AKP-së përmes Vendimit [Nr.Ref . BD-68], refuzoi kërkesën e parashtruesve për blerjen e banesës me arsyetimin se këta të fundit nuk kanë paraqitur Vendim për ndarje të banesës dhe Kontratë për shfrytëzim të banesës, duke mos argumentuar të drejtën banesore në kuptim të paragrafit 1.6 nenit 3 të Ligjit Nr.04-L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.
16. Më 5 janar 2015, parashtruesit e kërkesës kishin parashtruar padi në Kolegjin e Specializuar kundër Vendimit të lartpërmendur të AKP-së, me pretendimin se nuk ishte vërtetuar drejtë gjendja faktike sepse ata "*janë në shfrytëzim të banesës lëndore*" dhe se sipas tyre kanë prezentuar prova të mjaftueshme që banesa ju kishte ndarë atyre nga Enti i Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitimit në Banjë të Pejës.
17. Më 20 nëntor 2021, AKP-ja dorëzoi në Kolegjin e Specializuar përgjigje në padi duke kundërshtuar në të gjitha pikat padinë e parashtruesve.
18. Më 22 nëntor 2021, Kolegji i Specializuar përmes Aktgjykimit [C-III-15-0001] refuzoi si të pabazuar padinë, me arsyetimin se padia refuzohet në mungesë të "*provave valide siç janë Vendimi mbi ndarjen e banesës dhe Kontrata mbi shfrytëzimin e banesës të cilat janë prova esenciale*" sipas paragrafit 1.6 nenit 3 të Ligjit Nr.04-L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore.
19. Më 31 dhjetor 2021, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë në Kolegjin e Apelit, kundër vendimit të shkallës së parë, me pretendimin se kishin paraqitur mjaftueshëm prova si në kërkesën e tyre për blerjen e banesës të ushtruar pranë AKP-së dhe në Kolegjin e Specializuar, por të njëjtat nuk ishin marrë parasysh nga këto të fundit.
20. Më 3 shkurt 2023, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-22-0008] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesve duke vërtetuar si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e shkallës së parë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

21. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se përmes Aktgjykimit [AC-I-22-0008] të 3 shkurtit 2023 të Kolegjit të Apelit, u janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me

nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenein 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

22. Parashtruesit e kërkesës, si pretendim kryesor para Gjykatës kanë ngritur faktin se sipas tyre AKP-ja, Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit nuk kishin trajtuar në mënyrë meritore provat e paraqitura nga ta.
23. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës para Gjykatës theksojnë se “ *Për çudi, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, nuk vlerësoj të gjitha dëshmitë/provat e ofruara për të vërtetuar se mungesa e vendimit për ndarje të banesës, nuk do të ishte apstrahim i legjitimitetit të ndarjes së banesës. Po të ishte Vendimi për ndarje të banesës, sigurisht, AKP nuk do të refuzonte një rast të tillë. Duke kuptuar se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, ka këto përgjegjësi, për të konstatuar të vërtetën dhe për të legjitimuar mungesën e vendimit apo kontratës për ndarje të banesës, ajo nuk është lëshuar në konstatimin e legjitimitetit të dëshmive/provave tjera, të cilat fuqizojnë bindjen se banesa ju është ndarë në mënyrë të ligjshme z.Tahit dhe znj. Gjurgjica Ramcaj, nga Banja e Pejës, Komuna e Istogut.*

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

24. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

26. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

27. Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 29 [Llogaritja e periudhës kohore] dhe rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës:

Rregulli 29  
[Llogaritja e periudhës kohore]

*Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore, llogaritet si më poshtë:  
[...]*

*(d) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore.*

[...]

*(g) përjashtimisht, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.*

Rregulli 34  
[Kriteret e pranueshmërisë]

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

*(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit ;dhe*

28. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-22-0008] të 3 shkurtit 2023 Kolegjit të Apelit, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
29. Megjithatë, bazuar në nenin 49 (Afatet) të Ligjit, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse kërkesa e tanishme është dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës.
30. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton rregulli i afatit katër-mujor është autonom dhe duhet kuptuar dhe aplikuar bazuar në faktet e secilit rast veç e veç për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për të paraqitur kërkesën para Gjykatës. Gjykata thekson se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajve, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, i shërben sigurisë juridike dhe siguron që çështjet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe parandalon autoritetet dhe personat e tjerë të afektuar që të mos mbahen në një gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-se *Lekic kundër Sllovenisë*, kërkesa nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08 Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi

65). Ky rregull gjithashtu i jep kohë parashtruesit potencial nëse do të paraqes një kërkesë në Gjykatë, dhe, nëse po, të vendosë për argumentet specifike që do i paraqes si dhe rrjedhën e fakteve, pasi që me kalimin e kohës bëhet i vështirë shqyrtimi i çështjeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës (shih rastin e GEDNJ-së, *Sabri GÛNEŞ kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 52 dhe 55).

31. Afati katër (4) muaj fillon të rrjedhë nga dita e vendimit të fundit në kuadër të procesit të shterimit të mjeteve juridike (shih rastin e GJEDNJ-së, *Chapman kundër Belgjikës*, kërkesa nr.39619/06, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 34).
32. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se kur parashtruesit i njihet e drejta për të pranuar kopjen e vendimit përfundimtar të gjykatave të rregullta, bazuar në objektin dhe qëllimin e nenit 49 (Afati) të Ligjit, afati prej 4 (katër) muajsh fillon të rrjedhë në datën e marrjes së kopjes së vendimit (shih rastin e GJEDNJ-së, *Worm kundër Austrisë*, kërkesa nr 83/1996/702/894, Aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33)
33. Ky kriter është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrëhet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
34. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktgjykimin [AC-I-22-0008] të 3 shkurtit 2023 të Kolegjit të Apelit. Fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet që ndërliken me AKP-në, vërteton që parashtruesit e kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar më 8 shkurt 2023. Parashtruesit e kërkesës e kanë dorëzuar kërkesën e tyre në Gjykatë më 9 qershor 2023, ditë e premtë, respektivisht katër muaj e një ditë pas pranimit të vendimit të kontestuar.
35. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej katër (4) muajve të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht është e papranueshme për shqyrtim.
36. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesit të kërkesës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve 27, 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (1) (c), 39 dhe 45 të Rregullores së punës, më 13 shkurt 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtime me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani